



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË SË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

PROGRAM ORIENTUES I MATURËS SHTETËRORE
PËR ARSIMIN E ORIENTUAR
(SHKOLLAT E GJUHËVE TË HUAJA)

LËNDA:
“GJUHË E HUAJ”
(PROVIM I DETYRUAR)

VITI SHKOLLOR 2024 – 2025
KOORDINATORE: LUDMILLA STEFANI

PËRMBAJTJA

| | | |
|-----|--|----|
| 1 | HYRJE..... | 3 |
| 2 | UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT | 5 |
| 3 | STRUKTURA E TESTIT | 6 |
| 4 | REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI..... | 10 |
| 4.1 | Niveli B2 | 10 |
| 4.2 | Niveli B1 | 11 |
| 5 | TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA..... | 14 |
| 6 | PËRMBAJTJA E PROGRAMIT | 16 |

1 HYRJE

Programi orientues për përgatitjen e provimeve të Maturës Shtetërore për lëndën gjuhë e huaj vjen si sintezë e njohurive dhe shprehive të fituara gjatë gjithë procesit mësimor në këtë lëndë.

Hartimi i këtij programi orientues është bazuar tërësisht në dokumentet kurrikulare për lëndën gjuhë e huaj duke pasur parasysh zhvillimin e aftësive gjuhësore që do të testohen si dhe programet e viteve të mëparshme.

Ky program orientues synon:

- të ndihmojë nxënësit në përgatitjen e tyre për provimin e Maturës Shtetërore në lëndën gjuhë e huaj duke iu referuar programit të klasës së 12-të të gjuhës së huaj të parë, si edhe Kuadrit të përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët dhe Volumit Shoqërues;
- të ndihmojë mësuesin e lëndës për t'u dhënë orientimet e duhura nxënësve dhe për të punuar për zbatimin e programit;
- vlerësimin e njëkohshëm të 2 aftësive kryesore (nga katër aftësi që ka gjuha e huaj) që përbëjnë dhe **dy konceptet bazë**, që janë *të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim*;
- të japë orientime për mësuesit hartues të testeve të provimit të Maturës Shtetërore për gjuhën e huaj të parë;
- vlerësimin e të kuptuarit dhe të shprehurit duke mbajtur parasysh formimin e njohurive dhe shprehive të domosdoshme gjuhësore, komunikuese dhe funksionale si dhe arritjen e rezultateve të të nxënësve për nivelin përkatës në zbatim të kurrikulës me kompetenca të lëndës së gjuhës së huaj të arsimit të mesëm të lartë;
- aftësinë për të përdorur formimin gjuhësor në mënyrë të pavarur, korrekte dhe të përshtatshme me situata komunikimi të dhëna

Bazuar në udhëzimin e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore, testi i gjuhës së huaj hartohet në përputhje me gjuhën, e cila në planin mësimor trajtohet si gjuhë e huaj e parë dhe niveli i njohurive synohet të jetë B2, sipas “Kuadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët”.

Sipas specifikave të shkollave me drejtim të orientuar gjuhësor, për gjuhët të cilat fillojnë si gjuhë e huaj e parë në nivelin A1 në klasën e dhjetë, niveli i njohurive që do të testohet është B1¹.

Më poshtë jepet përshkrimi i nivelit B2 i cili i referohet shkallës globale të “Kuatrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët”.

| | | |
|----------------------------|-----------|--|
| Përdorues i pavarur | B2 | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton idetë kryesore të një teksti kompleks mbi çështje konkrete dhe abstrakte duke përfshirë diskutime teknike në fushën e tij të specializimit.</i> • <i>bashkëvepron rrjedhshëm dhe spontanisht duke e bërë komunikimin me folës vendas të mundshëm pa vështirësi për secilën palë.</i> • <i>prodhon një tekst të qartë, të detajuar rreth një sërë temash dhe shpjegon pikëpamjet e tij për një çështje të ditës, duke dhënë avantazhe dhe disavantazhe për opsione të ndryshme.</i> |
|----------------------------|-----------|--|

Tabela e mëposhtme jep përshkrimin e nivelit B1 i cili i referohet shkallës globale të “Kuatrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët” (Këtij niveli do t’i referohen mësuesit dhe nxënësit e gjuhëve të huaja në ato shkolla gjuhësore ku gjuha e huaj e parë fillon në klasën e dhjetë në nivelin A1.)

| | | |
|----------------------------|-----------|--|
| Përdorues i pavarur | B1 | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>kupton çështjet kryesore të një informacioni standard të qartë për tema të njohura që hasen rregullisht në shkollë, punë, argëtim etj.</i> • <i>menaxhon situata të cilat i has gjatë një udhëtimi në vende ku flitet gjuha që mëson.</i> • <i>prodhon materiale të thjeshtë për tema të njohura ose të një fushe</i> |
|----------------------------|-----------|--|

¹ Niveli B1 për provimin e maturës shtetërore ju referohet atyre gjuhëve të huaja të cilat në shkollat me drejtim të orientuar gjuhësor fillojnë si gjuhë e huaj e parë në nivelin A1 në klasën e dhjetë pasi nuk zhvillohen në Arsimin e Mesëm të Ulët, si p.sh. Rusisht, Turqisht, Gjermanish, Spanjisht etj.

| | | |
|--|--|---|
| | | <p><i>të interesit personal.</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • <i>përshkruan përvoja, ngjarje, ëndrra, shpresa, ambicie dhe shkurtimisht shpjegon ose jep arsye për opinionet dhe planet e tij personale.</i> |
|--|--|---|

2 UDHËZIME PRAKTIKE MBI PËRDORIMIN E PROGRAMIT

Për përdorimin e këtij programi mësuesi duhet të ketë parasysh specifikën e gjuhës së huaj, pasi nxënësi në provim do të përballet me pjesë të reja leximi, megjithëse tematika, gramatika dhe funksionet gjuhësore do të jenë po ato që ka studiuar ndër vite.

Kur flitet për tematikën kryesore në program, nxënësit duhet të kenë njohuri për temat që janë të përfshira në program nga ***jeta e përditshme, bota e shkollës dhe e punës, jeta personale dhe shoqërore, bota rreth nesh, bota e komunikimit etj.***

Përsa i përket gramatikës, mësuesi duhet t'i përgatisë nxënësit që të jenë në gjendje të zgjidhin ushtrime mbi aspektet kryesore gramatikore të studiuara gjatë shkollimit dhe t'i përdorin ato në mënyrë të pavarur ose dhe në kontekst të një situatë të re.

Mësuesi duhet t'i vërë theksin anës praktike të trajtimit të strukturave gramatikore nëpërmjet ushtrimeve të shumëllojshme të dhëna në tekstin shkollor, fletoren e punës dhe më gjerë.

Funksionet gjuhësore duhet të trajtohen në mënyrë sa më të larmishme duke përdorur situata nga të gjitha fushat e jetës të cilat trajtohen në nivelin B2 dhe nivelin B1 (nivelit B1 do t'i referohen mësuesit dhe nxënësit e gjuhëve të huaja në ato shkolla gjuhësore ku gjuha e huaj e parë fillon në klasën e dhjetë në nivelin A1).

Për sa i përket të shkruarit, mësuesi duhet të ushtrojë nxënësit të jenë të aftë të përmbushin kërkesat e nivelit përkatës gjuhësor përmes të shkruarit të një letre/e-mail formale, eseje, raporti, prezantimi, përmbledhje artikujsh deri në argumentim materiali.

3 STRUKTURA E TESTIT

Testi i gjuhës së huaj ndërtohet mbi bazën e dy aftësive dhe vlerësimin e njëkohshëm të tyre që janë të kuptuarit dhe të shprehurit me shkrim.

Nëpërmjet testit të lëndës gjuhë e huaj në provimin e Maturës Shtetërore, nxënësi do të vlerësohet për realizimin e kompetencave gjuhësore.

Niveli B2

| Kompetencat e lëndës gjuhë e huaj | Përshkrimi i kompetencave |
|--|--|
| Kompetenca gjuhësore | Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• zotëron fjalor të pasur për tema të përgjithshme dhe ato që lidhen me fushën e tij të interesit;• përdor formulime të ndryshme fjalish për të shmangur përsëritjet, por akoma mund të vihen re moment hezitimi. Saktësia gjuhësore është në përgjithësi e lartë, megjithëse mund të shfaqen moment konfuzioni pa ndikuar në komunikim;• tregon shkallë të lartë kontrolli gramatikor duke mos bërë gabime të cilat mund të çojnë në keqkuptime;• shkruan në mënyrë inteligjente tekste të gjata dhe të qarta duke zbatuar strukturën standarde të organizimit të paragrafëve dhe të gjithë tekstit. Drejtshkrimi dhe pikëzimi janë të saktë, por mund të ketë shenja të influencës së gjuhës amtare. |
| Kompetenca socio-gjuhësore | Nxënësi: <ul style="list-style-type: none">• me pak përpjekje, merr pjesë dhe vazhdon një diskutim në grup edhe kur flitet shpejt dhe me shprehje idiomatike;• diskuton me një folës vendas të asaj gjuhe duke mos shkaktuar keqkuptime dhe duke u shprehur në mënyrë të përshtatshme dhe pa gabime në formulimin e ideve. |

| | |
|------------------------------|--|
| Kompetenca pragmatike | <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none"> • përshtatet kur në diskutim ndryshohet tema dhe stili duke përshtatur formulimet sipas rastit; • riformulon një ide për të theksuar ose shpjeguar më mirë një çështje të caktuar; • fillon, vazhdon dhe përmbyll diskutimin në mënyrë efektive duke e marrë radhën aty kur duhet dhe në mënyrë të përshtatshme; • tregon ose përshkruan në mënyrë të qartë duke zgjeruar dhe mbështetur pikat kryesore me shpjegime dhe shembuj të detajuar; • përdor mjete të kufizuara lidhëse për të realizuar të folur të qartë dhe koherent; • shkruan një tekst që në përgjithësi është i mirëorganizuar dhe koherent, duke përdorur një sërë shprehjesh lidhëse; • strukturon një tekst të gjatë në paragrafë të qartë dhe logjik; • përshkruan qartë, duke zgjeruar dhe mbështetur argumentat kryesorë me detaje, shpjegime dhe shembuj. • zhvillon një argument të qartë, duke zgjeruar dhe mbështetur këndvështrimin e tij në një farë mase me detaje dhe shembujt përkatës. • vlerëson avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve të ndryshme; • shpjegon qartë ndryshimin midis faktit dhe opinionit. |
|------------------------------|--|

Niveli B1

| | |
|--|---|
| Kompetencat e lëndës gjuhëse huaj | Përshkrimi i kompetencave |
| Kompetenca gjuhësore | <p>Nxënësi</p> <ul style="list-style-type: none"> • zotëron fjalor të mjaftueshëm për të përshkruar situata të njohura dhe të paparashikuara, shpjegon me saktësi, por ndonjëherë edhe |

| | |
|--|--|
| | <p>me hezitim pikat kryesore të një problemi duke përdorur edhe fjali të përbëra;</p> <ul style="list-style-type: none"> • ka fjalor të mjaftueshëm për t`u shprehur rreth fushave të tij të interesit si familja, interesat, dëshirat, udhëtimet, puna dhe ngjarjet aktuale; • demonstroi saktësi leksikore relativisht të lartë, por akoma bën gabime kur shpreh mendime mbi situata të vështira dhe të panjohura për të; • tregon relativisht një shkallë të lartë kontrolli dhe komunikim me saktësi gramatikore në kontekste të njohura, si edhe nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime të asaj që do të shprehë, ndonjëherë mund të ndikohet nga gjuha amtare; • është i qartë në të folur dhe në shqiptimin e fjalëve, megjithëse ka raste të pakta kur shqiptimi nuk është i saktë; • krijon tekste të gjata dhe shkruan pothuajse pa gabime dhe është i saktë në përdorimin e shenjave të pikësimit, pavarësisht se ndonjëherë mund të tregojë ndikime të gjuhës amtare. |
| <p>Kompetenca socio-gjuhësore</p> | <ul style="list-style-type: none"> • kryen dhe iu përgjigjet një game të gjerë funksionesh gjuhësore duke përdorur shprehjet e zakonshme të një regjistri neutral; • njeh rregullat e mirësjelljes dhe vepron në mënyrë të përshtatshme me to; • shprehet qartë në situata të ndryshme dhe shmang gabimet në formulimin e ideve; • njeh mirë ndryshimet midis kulturave, qëndrimeve, vlerave dhe besimeve që mbizotërojnë në vendin e tij dhe në vendet ku flitet gjuha e huaj; • përshtat shprehjet e mësuara për t`i përdorur në situata më pak të njohura dhe të vështira për të. |

| | |
|------------------------------|---|
| Kompetenca pragmatike | <ul style="list-style-type: none"> • ndërhyt dhe merr fjalën në një bisedë me temë të njohur për të duke përdorur shprehjet e mësuara; • tregon në mënyrë logjike dhe të rrjedhshme një tregim ose përshkrim në mënyrë lineare, por ka raste që përdor argumente dhe shembuj të tjerë; • lidh pjesë të shkurtra dhe të thjeshta në një tekst të plotë në mënyrë lineare duke tentuar për tekste më të komplikuara. |
|------------------------------|---|

Përmbushja e kompetencave gjuhësore që një nxënës duhet të zotërojë në përfundim të shkollës së mesme, klasa XII në nivelin B2 (dhe B1 për gjuhët e huaja që fillojnë si gjuhë e huaj e parë në klasën e dhjetë) janë sipas tabelës më poshtë:

| Aftësitë gjuhësore që do të vlerësohen | Përqindja |
|--|------------------|
| Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar | 50% |
| Përdorimi i drejtë i gjuhës (gramatika dhe leksiku) | 25% |
| Të shkruarit | 25% |

4 REZULTATET E TË NXËNIT PËR SECILËN AFTËSI

4.1 Niveli B2

| Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar |
|---|
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• lexon artikuj dhe raporte të ndryshme që kanë lidhje me probleme bashkëkohore ku autorët e këtyre pjesëve përshtatin qëndrimin dhe këndvështrimin e tyre;• kupton pjesë letrare dhe joletrare bashkëkohore;• lexon dhe kupton një tekst të gjatë relativisht shpejt si dhe kupton përmbajtjen dhe gjen thelbin e një informacioni, të një artikulli apo një reportazhi me një gamë të gjerë temash profesionale apo tema nga sfera të tjera.• lexon dhe kupton se çfarë shkruhet në një letër/ e-mail formal ose në një krrespondencë formale ku trajtohen tema më pak të njohura për të;• lexon shpejt një tekst të gjatë dhe kompleks për të gjetur detajet e kërkuara;• identifikon shpejt përmbajtjen dhe rëndësinë e artikujve të lajmeve, artikujve dhe raporteve në një gamë të gjerë me tema nga jeta e punës;• kupton artikuj dhe raporte që kanë të bëjnë me probleme bashkëkohore në të cilat trajtohen qëndrime ose pikëpamje të ndryshme;• dallon kur një tekst ofron informacion faktik ose kur teksti kërkon të bindë lexuesit;• njeh struktura të ndryshme në tekstin diskursiv: argumente të kundërta, problem-zgjidhje, marrëdhëniet shkak-pasojë. |
| Përdorimi i drejtë i gjuhës |
| <p>Nxënësi:</p> <ul style="list-style-type: none">• përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të përbëra gjuhësore dhe gramatikore duke i përdorur ato saktë dhe pa gabime ortografike;• përdor mjaft mirë një repertor të shprehjeve dhe frazave që bashkëngjiten me situata pothuajse të paparashikuara për të;• ka një gamë të gjerë të fjalorit për tema lidhur me fushën e tij dhe tema të tjera të përgjithshme;• ndryshon formulimin e tij për të shmangur përsëritje të shpeshta, por mangësitë leksikore mund të shkaktojnë ende hezitime dhe përdorime të perifrastave; |

- ka një kontroll të mirë mbi aspektin gramatikor;
- bën gabime të rastësishme dhe jo sistematike, bën rrallë gabime sintaksore duke e korigjuar veten;
- duke pasur një kontroll të mirë gramatikor, nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime.

Të shkruarit

Nxënësi:

- shkruan ese dhe raporte që zhvillojnë një argumentim në mënyrë metodike duke theksuar në mënyrë të përshtatshme pikat e rëndësishme dhe hollësitë e spikatura që e mbështesin atë;
- vlerëson idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi;
- paraqet argumentim pro ose kundër një pikëpamjeje të caktuar duke shpjeguar përparësitë ose problemet e opsioneve të ndryshme;
- sintetizon informacione dhe argumente të marra nga burime të ndryshme;
- përshkruan qartë dhe në mënyrë të hollësishme një sërë temash që lidhen me fushën e tyre të interesit;
- shkruan një përmbledhje të një filmi ose drame që ka parë ose të një libri që ka lexuar;

4.2 Niveli B1

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar

Nxënësi:

- lexon artikuj dhe raporte të ndryshme që kanë lidhje me probleme dhe tema nga fushat e tij të interesit;
- kupton pjesë letrare dhe joletrare bashkëkohore;
- lexon dhe kupton një tekst relativisht shpejt si dhe kupton përmbajtjen dhe gjen thelbin e një informacioni, të një artikulli apo një reportazhi me tema nga fushat e tij të interesit.
- lexon dhe kupton një tekst/letër/e-mail ku përshkruhen në mënyrë të detajuar ngjarje, përvoja, ndjenja dhe dëshira;
- kupton një korrespondencë standarde zyrtare dhe postime në internet rreth fushave të tij të interesit;

- gjen informacion specifik në tekste konkrete dhe të panjohura për (p.sh. udhëzues udhëtimi, receta), me kusht që ato të jenë të shkruar në gjuhë të thjeshtë;
- lexon dhe kupton informacionin kryesor në përshkrime të shkurtra dhe të thjeshta të mallrave në broshura dhe faqe interneti (p.sh. pajisje digjitale portative, kamera).
- kupton pikat e rëndësishme në artikuj të lajmeve mbi tema të njohura për të;
- kupton shumicën e fakteve në një tekst ku trajtohen tema të njohura dhe me interes për të, me kusht që të ketë kohë të mjaftueshme për rilexim.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Nxënësi:

- përcjell mesazhin me shkrim nëpërmjet strukturave të sakta gjuhësore dhe gramatikore dhe pa gabime ortografike;
- përdor mjaft mirë një repertor të shprehjeve dhe frazave që bashkëngjiten me situata të parashikuara për të;
- ka një gamë të mjaftueshme fjalori për tema lidhur me fushën e tij të interesit dhe tema të tjera të përgjithshme;
- ndryshon formulimin e fjalive për të shmangur përsëritje të shpeshta, por mangësitë leksikore mund të shkaktojnë ende hezitime dhe përdorime të perifrashave;
- ka një kontroll të mirë mbi aspektin gramatikor; bën gabime të rastësishme dhe jo sistematike, bën rrallë gabime sintaksore duke e korrigjuar veten;
- duke pasur një kontroll të mirë gramatikor, nuk bën gabime që të çojnë në keqkuptime.

Të shkruarit

Nxënësi

- shkruan ese dhe raporte që zhvillojnë një argumentim në mënyrë metodike duke theksuar në mënyrë të përshtatshme pikat e rëndësishme dhe hollësitë e spikatura që e mbështesin atë;
- vlerëson idetë e ndryshme ose zgjidhjet e një problemi;
- paraqet argumentim pro ose kundër një pikëpamjeje të caktuar duke shpjeguar përparësitë ose problemet e opsioneve të ndryshme;
- përshkruan në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të hollësishme një sërë temash të njohura brenda fushës së tij të interesit;
- përshkruan përvojat, ndjenjat dhe reagimet e tij në një tekst të thjeshtë;

- harton një raport shumë të shkurtër në një format standard të dhënë, i cili transmeton informacione rutinë faktike;
- shkruan një letër/e-mail personal duke kërkuar ose përcjellë informacione të thjeshta dhe duke theksuar pikat që ai mendon se janë të rëndësishme;
- shkruan një letër/e-mail personal që përshkruan përvoja, ndjenja, ngjarje duke dhënë edhe disa detaje;
- shkruan një letër/e-mail të thjeshtë aplikimi dhe jep detaje të kufizuara mbështetëse;
- poston një kontribut të kuptueshëm në një diskutim në internet për një temë të njohur me interes;
- bën postime personale në internet për përvojat, ndjenjat dhe ngjarjet nga jeta e tij e përditshme.

5 TIPET E USHTRIMEVE TË REKOMANDUARA

Të lexuarit dhe të kuptuarit e një teksti të shkruar

Përshkrimi

Vlerësimi i kësaj aftësie do të bëhet mbi bazën e disa teksteve të panjohura me tema aktuale që lidhen me interesat e të rinjve mbi të cilat do të ndërtohen pyetje që do të testojnë aftësinë e nxënësit për të kuptuar një pjesë letrare ose joletrare apo gjini tjetër e të shkruarit (reklama, informacione, letra, pjesë nga broshura të ndryshme turistike, etj.)

Nxënësi duhet të jetë në gjendje të lexojë dhe të kuptojë në mënyrë të përgjithshme dhe të detajuar informacionin e dhënë në pjesën e leximit, të mbledhë informacionet që i kërkohen rreth tekstit apo të japë një vlerësim ose opinionin e tij të mbështetur mbi fakte në pjesën që lexon.

- Pyetje mbi idenë kryesore të tekstit.
- Pyetje mbi kuptimin e përgjithshëm të tekstit.
- Pyetje për të shpjeguar shkakun e një ngjarjeje në tekst.
- Pyetje mbi informacione specifike në tekst.
- Pyetje mbi detaje të ndryshme që dalin në tekst.
- Pyetje për gjetjen e kuptimit të fjalëve nga konteksti.
- Plotësimi i vendeve bosh me informacionin e duhur.
- Ushtrime me përgjigje *po/jo*.
- Pyetje të hapura me përgjigje të shkurtra ose të strukturuar mirë.
- Ushtrime me disa alternativa (përzgjedhje e alternativës së saktë nga 4 alternativat).
- Vendosja e paragrafëve sipas rendit të duhur në renditjen e ngjarjeve.
- Pyetje rreth mendimit personal të nxënësit për problemet e trajtuara në tekst (mendimi kritik).
- Pyetje për të gjetur nënkuptimin e një fjale ose shprehjeje.
- Pyetje për të gjetur lidhjen shkak pasojë.
- Pyetje për të ofruar zgjidhje të ndryshme.

Përdorimi i drejtë i gjuhës

Përshkrimi

Njohuritë kryesore që nxënësi ka marrë mbi përdorimin e gjuhës ndër vite, do të testohen përmes ushtrimeve që e shohin gramatikën dhe leksikun si pjesë të integruara në situata të gjuhës së përdorur në përditshmëri; pra si një gjuhë funksionale.

- Ushtrime me plotësime hapësirash ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësinë e duhur gramatikore. Ushtrimi ndërtohet mbi një tekst të shkurtër ose paragraf me një temë të caktuar. Gramatika dhe leksiku ndërthuren bashkë në atë çka i kërkohet nxënësit të plotësojë.
- Ushtrime me zgjedhje alternativash.
- Ushtrime me plotësime vendesh bosh në dialogje me tema nga jeta e përditshme.
- Ushtrime me plotësime hapësirash ku nxënësi duhet të vendosë fjalën ose njësinë e duhur gramatikore, ku fjalët që i duhet të vendosë i jepen në një listë nga e cila ai gjen fjalën ose njësinë e duhur gramatikore për të plotësuar tekstin apo paragrafin në mënyrë që ai të jetë i saktë.
- Situata komunikimi me hapësira bosh të cilat duhet të plotësohen nga nxënësi me fjalët e tyre. Nxënësit do t'i duhet ta plotësojë situatën komunikative me fjalë dhe aspekte gjuhësore që mungojë duke e bërë atë të plotë e me kuptim.

Të shkruarit

Përshkrimi

Nxënësi mund të prodhojë me shkrim një tekst të detajuar rreth temave me subjekte që lidhen me fushën e tij të interesit duke bërë analizë dhe sintezë si dhe të shpjegojë këndvështrimin e tij rreth temës duke dhënë avantazhet dhe disavantazhet e opsioneve të ndryshme që ai rendit në këtë pjesë të shkruar.

- ese argumentuese
- përmbledhje filmi, libri
- artikull në gazetën e shkollës
- shkrimi i një letre/email formal (aplikim, rekomandim, ankese etj)
- shkrimi i një raporti

6 PËRMBAJTJA E PROGRAMIT

Nxënësit në provim do të përballen me situata ose pjesë të reja leximi, por *tematika*, *gramatika* dhe *funksionet gjuhësore* do të jenë ato që nxënësit kanë studiuar për këtë nivel gjuhe (B2) dhe B1 për gjuhët që fillojnë si gjuhë e huaj e parë në klasën e dhjetë nivelin A1.

Tematikat me të cilat do ndeshen në provimin e maturës shtetërore o të përfshijnë temat bazë sipas kurrikulës dhe “Kwadrit të Përbashkët Evropian të Referencave për Gjuhët” i cili së bashku me Portofolin European të Gjuhëve janë materialet referuese për të gjitha gjuhët që mësohen në sistemin tonë parauniversitar.

- **Jeta e përditshme** (*organizimi i një plani ditor dhe i kohës së studimit; kujtime të mrekullueshme- dita më e bukur e jetës sime; qëllimet afatshkurtra dhe afatgjata; çfarë dua unë për të ardhmen time etj.*)
- **Bota e shkollës dhe e punës** (*organizimi i një biznesi të vogël; shqetësimet e shoqërisë së sotme si papunësia etj.; studimet dhe universitetet në vend dhe në botë etj.*)
- **Jeta personale dhe shoqërore** (*shanse dhe të drejta të barabarta për gratë dhe burrat, të rinjtë dhe të rriturit; vendlindja; personalitete në shoqëri etj.*)
- **Bota rreth nesh** (*arti në shekuj; e ardhmja, flora dhe fauna; historia e filmit; programet televizive; zakonet dhe traditat në vendet ku flitet gjuha që po mësohet; momente të rëndësishme të historisë botërore; personalitete në fusha të ndryshme të jetës etj.*)
- **Bota e komunikimit** (*bota e teknologjisë; rrjetet sociale; të shkruarit e letrave- letër kërkesë, letër ankesë, letër biznesi, ese etj.*)

Përdorimi i gjuhës do trajtojë:

a) Elementet dhe strukturat gramatikore

Për një komunikim të saktë nga ana gramatikore, sugjerohet të punohet në mënyrë të përqendruar mbi strukturat dhe çështjet gramatikore më të rëndësishme sipas specifikave të çdo gjuhe të cilat duhet të trajtohen nëpërmjet ushtrimeve të ndërtuara si bashkëbisedime në situata të ndryshme ose në pjesë leximi me tema nga jeta e përditshme shoqërore dhe akademike. Nxënësi duhet të ketë njohuri për konceptet gramatikore të prezantuara më poshtë.

- *ndajfoljet e mënyrës, kohës etj.; mbiemrat dhe strukturat e tyre; fjalitë e përbëra; format e përbëra të foljeve në kohë të tashme, të shkuar dhe të ardhme; ligjërata e drejtë dhe e*

zhdrejtë në format e përbëra të foljeve; mënyra jo veprare në format e përbëra të foljeve; foljet modale; fjalitë kushtore, nyjet, emrat etj.

b) Funkcionet gjuhësore

Funksionet e ndryshme gjuhësore, sipas specifikave të gjuhës së huaj e cila do të testohet, duhet të trajtohen nëpërmjet ushtrimeve të ndërtuara si bashkëbisedime në situata të ndryshme të jetës së përditshme. Nxënësi duhet të jetë i përgatitur kryesisht për këto situata gjuhësore.

- *dhënia e këshillave; të shprehurit e keqardhjes; theksimi i informacionit; të shprehurit e mendimin ose opinionit personal; vënia në diskutim ose të mos biesh dakord me dikë; sugjerime, ftesa etj.*